

Mendo për gjërat që ndikojnë në jetën tënde...

### shpjegim i fjalëve

... familja, shkolla, komuniteti dhe ambienti lokal, policia, doktorët dhe spitalet, media, qeveria. A mendon që ti luan një rol në punën e tyre?

Ky udhëzues mund të të ndihmojë të luash një rol në gjithë këto fusha dhe më shumë.

Mund të kesh dëgjuar shumë për qytetarinë, pjesëmarrjen dhe demokracinë. Cila është domethënia e tyre? Të jetosh në demokraci do të thotë që ti ke të drejtë të thuash sesi bëhen gjërat në nivel lokal, kombëtar dhe botëror. Të bësh këtë gjë në praktikë do të thotë dy gjëra: pjesëmarrje në komunitet dhe të jesh një qytetar aktiv. Mos lër që këto fjalë të të pengojnë ato kanë një domethënie:

Demokraci fjalë për fjalë do të thotë qeverisje nga të gjithë njerëzit. Sesi ajo vihet në jetë, ndryshon nga një vend në tjetrin, po gjithmonë do të thotë që të gjithë qytetarët kanë të drejtë dhe

pushtet të ndikojnë dhe veprojnë në çështjet që kanë të bëjnë me ta.

Qytetari aktive do të thotë të kuptosh të drejtat dhe përgjegjësitë e tua si qytetar në një demokraci dhe të kesh aftësitë dhe besimin për t'i vënë ato në jetë.

Pjesëmarrje do të thotë të luash një rol aktiv në vendimet dhe shërbimet që kanë të bëjnë me ty; fillon me thënien e asaj që mendon për këto shërbime (si shëndeti dhe arsimit) deri në veprimin që mund të merrni për të ndryshuar komunitetin tuaj, në votimet për zgjedhjet lokale dhe kombëtare.

### njih të drejtat e tua

Nëse je nën 18 vjeç nuk mund të votosh, por ke të drejtë të thuash atë që mendon për vendimet që kanë të bëjnë me ty. Kjo të jep pushtet të ndryshosh jetën tënde dhe të tjerëve.

Gjithkush ka të drejta njerëzore. Por njerëzit nën 18 kanë gjithashtu dhe të drejtat e tyre, të njohura si Konventa për të Drejtat e Fëmijës të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (KDFOKB).

Është përgjegjësi e gjithkujt të respektojë të drejtat e tua, përfshi këtu dhe të drejtën për të jetuar dhe për t'u

zhvilluar, të drejta themelore si ajo e të ushqyerit, e ujit të pastër, strehimit, shëndetit, arsimit dhe të drejtën për t'u mbrojtur nga shfrytëzimi apo diskriminimi.

Duke nënshkruar KDFOKB-në qeveria shqiptare ka rënë dakord të respektojë të gjitha këto të drejta dhe më shumë madje. Organizata e Kombeve të Bashkuara bën kontrolle të rregullta në mënyrë që të sigurojë që qeveria i mban premtimet e saj

KDFOKB thotë që ti ke të drejtë të thuash mendimin tënd dhe mendimet e tua të konsiderohen seriozisht në të gjithë në çështjet që kanë të bëjnë me ty. Ti gjithashtu ke të drejtë të marrësh informacion mbi çështjet që janë të rëndësishme për ty dhe të shprehësh mendimet dhe opinionet e tua lirshëm, por pa shkelur të drejtat e të tjerëve.

### luaj një rol... në nivel lokal

#### Qendrat dhe Shoqatat Rinore

Një nga mënyrat më të mira për të vepruar është të shkosh tek Qendra Rinore ose Qendra Kulturore e Fëmijëve dhe të shikoni se çfarë po bëhet. Mund dhe të përpiqesh të bëhesh anëtar i këtyre qendrave ose mund të frekuentoni këto qendra. Atje mund të merrni informacion mbi organizatat rinore që ekzistojnë dhe sesi mund të aktivizoheni në to. Duke qenë se ato drejtohen nga të rinj, ato janë një mënyrë sesi mund të bëni zërin tuaj të dëgjohet në nivel lokal. Nëse atje ku banoni nuk ka asnjë

organizatë rinore, atëherë ju mund të ngrini një, KDFOKB ua jep këtë të drejtë (neni 15).

#### Qeveria e nxënësve ose senati i shkollës

Mendimet tuaja sesi duhet të drejtohet shkolla kanë shumë rëndësi dhe mund të ndryshojnë shumë gjëra. Në shumë shkolla janë ngritur qeveritë e nxënësve ose senate për të shprehur mendimet e tyre. Nëse shkolla jote nuk ka një qeveri apo senat, pyet mësuesin tënd sesi mund ta ngrini.

### luaj një rol... në nivel kombëtar

Nëse keni vendosur që të jepni mendimin tuaj pse të mos shkoni dhe në shkallë më të lartë?

Pyet për strukturat rinore që janë dhe gjej atë që është më e përshtatshme për ty. Ka shumë organizata tek të cilat ti mund të drejtohesh, ato janë atje për të bërë zërin tënd të dëgjohet. Aty mund të ndihmohesh si vullnetar ose mund të gesh trajnime në fusha të ndryshme.

#### Neni 12

Neni 12 thekson se çdo fëmijë, i cili është i aftë të ketë pikëpamjet e tij, ka të drejtën për t'i shprehur lirisht këto pikëpamje, për çdo çështje që ka të bëjë me të.

Për këtë qëllim, fëmijët i jepet mundësia që të dëgjohet në çdo procedurë gjyqësore ose administrative, që ka të bëjë me të.

#### Neni 15

Neni 15 thekson se shteti njez të drejtën e fëmijës për lirinë e organizimit dhe lirinë e grumbullimit paqësor. Që do të thotë se fëmijët kanë të drejtë të mblidhen në grupe dhe shoqata (qeveria e nxënësve, ambientalistët grupi i letrave). Fëmijët kanë të drejtë të manifestojnë së bashku në rrugë duke kërkuar diçka.

Fëmijët kanë të drejtë të mblidhen ose të manifestojnë derisa nuk shkelen të drejtat e të tjerëve.

### luaj një rol... në nivel botëror

Si qytetar i botës, ke pushtetin të luftosh për ato çështje për të cilat ti shqetësohesh ose të përfaqësosh njerëz të tjerë. Nëse do të përfshihesh në fushata të tilla kontakto me:

**Save the Children**

Save the Children organizon konsultime me të rinjtë dhe fëmijët për çështje të ndryshme. Për njohuri të mëtejshme mund të vizitoni faqen tonë të internetit me adresë [www.savealbania.org](http://www.savealbania.org)

### Rast nga jeta

Fëmijët e 11 shkollave 8-vjeçare në Dibër dhe Korçë, ngritën qeveritë e nxënësve, bazuar në kriteret e hartuara vetë, si edhe me zgjedhje të lira. Ky grup vendosi të vëzhgonte, regjistronte dhe monitoronte respektimin e të drejtave të fëmijës në shkollë. Kështu që vendosën një "Kuti sugjerimesh" në shkollë, ku të gjithë nxënësit e shkollës mund të shkruanin shqetësimet që kishin në lidhje me respektimin e të drejtave të tyre nga mësuesit, drejtuesit, shokët. Qeveria e nxënësve e hap këtë kuti çdo muaj dhe bazuar në përmbajtjet e letrave harton listën e shqetësimeve, sugjerimeve, pa përmendur emra nxënësish apo mësuesish, në mënyrë që të shmanget keqkuptimi apo konflikte të panevojshme. Kjo listë shqetësimesh e sugjerimesh varet në këndin e shkollës për t'u njohur nga nxënësit dhe mësuesit. Lista i jepet drejtorisë së shkollës, e cila e diskuton me mësuesit në mbledhjet e këshillit pedagogjik.

Pjesëmarrja e nxënësve është rritur dhe u ka ofruar atyre mundësi në zgjidhjen e problemeve për respektimin e të drejtave të tyre.

Për informacion të mëtejshëm mbi KDFOKB ose një kopje të saj kontaktoni me:

 **Save the Children**  
Programi për Shqipërinë  
Rruga "Komuna e Parisit",  
Lagjia 8, Pallatet 1 Maji,  
Vila "Lami", Tirana - Albania  
Tel: +355 4 261 840/929;  
Fax: +355 4 263 428  
E-mail: [savealbania@savealbania.org](mailto:savealbania@savealbania.org)

### Bëhu i mënçur

duke thënë  
mendimin tënd

E drejta e fëmijëve dhe të rinjve për t'u dëgjuar